

CILAT JANË KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL?

Për pranimin në shërbimin civil, një kandidat duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

04 22 68 141

kms hc@kms hc.al

Rruga "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini",
Tiranë

kms hc23@gmail.com

Cilat janë afatet për dorëzimin e dokumentacionit?

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është të paktën 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në:

- Faqen zyrtare të DAP-it (www.dap.gov.al) dhe AKPA-së (www.puna.gov.al) për institucionet e administratës shtetërore.
- Faqen zyrtare të AKPA-së (www.puna.gov.al), si dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në standat e informimit të publikut, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

HYRJE NË **SHËRBIMIN CIVIL**

KMSHC
Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Si realizohet pranimi në shërbimin civil?

Pranimi në shërbimin civil realizohet vetëm përmes një procedure konkurrimi kombëtar. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, që përfshin paraseleksionimin, testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

Pranimi për herë të parë në shërbimin civil bëhet vetëm në kategorinë ekzekutive, por ka edhe përjashtime, si psh:

- Pranimi i kandidatëve nga jashtë shërbimit civil për të konkurruar në një numër të limituar pozicionesh të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues;
- Në bazë të një konkursi për t'u bërë pjesë e trupës së nivelit të lartë drejtues që është i hapur për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Kush e realizon pranimin në shërbimin civil?

Procedura e konkurrimit realizohet nga njësi përgjegjëse. Për institucionet e administratës shtetërore, rolin e kësaj njësie e kryen DAP, ndërsa për institucionet e pavarura / njësitë e qeverisjes vendore, njësi përgjegjëse është njësi e burimeve njerëzore e krijuar brenda institucionit.

Si mund të bëhesh nëpunës civil?

1

Kontrollo për vende vakante të publikuara. Për institucionet e administratës shtetërore, shpallja e procedurës së pranimi për secilin grup publikohet në faqen zyrtare të DAP-it (www.dap.gov.al) dhe AKPA-së (www.puna.gov.al), ndërsa për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore shpallja bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e tyre të internetit. Shpallja qëndron e publikuar deri në përfundimin e procedurës së pranimi.

2

Shiko nëse ndonjë nga pozicionet i përshtatet kualifikimit tënd.

3

Plotëso dokumentet e nevojshme për aplikim, të cilat i gjen të përcaktuara në shpallje, duke respektuar afatin e caktuar për dorëzimin e tyre.

4

Kalo procedurën e vlerësimit që përfshin paraseleksionimin, testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

Çfarë informacioni mund të gjelesh tek shpallja e vendit vakant?

Fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim.

Fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi (me shkrim dhe me gojë).

Numrin e vendeve të planifikuara për të cilat do të bëhet pranimi.

Kërkesat e përgjithshme, në përputhje me nenin 21, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil," i ndryshuar.

Përshkrimin e përgjithshëm të punës së grupit/grupeve të administrimit të përgjithshëm/të posaçëm, për të cilin do zhvillohet konkurrimi.

Kërkesat e veçanta të grupit të administrimit të përgjithshëm/të posaçëm.

Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre.

Afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike.

Datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve.

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e vlerësimit paraprak, si dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve.

Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.